



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:187793

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05779059

C.nr.971/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen civile të paditësit S. B nga fsh. P, K e S, të cilin e përfaqëson i autorizuari N.B, avokat nga S, ndaj të paditurve RR.G, L.G, S.G, S.M, V.G, V.P dhe V.L, të cilët i përfaqëson i autorizuari D. F, avokat nga S, duke vendosur konform marrëveshjes së arritur në procedurën e ndërmjetësimit me datë 15.05.2024, në mes të palëve ndërgjyqëse, gjykata me datë 04.06.2024, jashtë seance, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur ne procedure te ndërmjetësimit, e evidentuar me nr. Ndm.nr.163/24, e datës 15.05.2024, e lidhur në mes të paditësit S. B nga fsh. P, K e S, të cilin e përfaqëson i autorizuari N.B, avokat nga S, dhe të paditurve RR.G, L.G, S.G, S.M, V.G, V.P dhe V.L, të cilët i përfaqëson i autorizuari D. F, avokat nga Suhareka.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 13.09.2022, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi, ndaj të paditurve, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, me vlerë të kontestit në shumën prej 2.500.00 euro.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse me parashtrësën e datës 29.11.2023, kanë kërkuar që lëndë të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit, meqenëse në mes të palëve nuk ka pasur dhe nuk ka asgjë kontestuese.

Gjykata me datë 19.04.2024, ka nxjerrë vendim, ku lëndën e ka referuar në procedurën e ndërmjetësimit, për procedim të mëtutjeshëm.

Marrëveshja në mes të palëve ndërgjyqëse, pranë këtij institucioni është arritur me numër Ndm.nr.163/24, me datë 15.05.2024, ku pas arritjes së saj lënda sërish i është kthyer gjykatës, ku pjesë e saj është edhe marrëveshja e arritur në mes të palëve.

Nga e njëjta konstatohet se palët me vullnetin e tyre kishin arritur ta zgjidhnin kontestin, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella në kuptim të përmbushjes së detyrimeve.

Sipas marrëveshjes dhe shkresave të bashkangjitura, siç janë, Aktvdekja për të ndjerën S. I. G, me nr.61, e lëshuar me datë 19.08.2022, nga ZJGC-Suharekë, me anë të së cilës gjykata ka bërë rregullimin e legjitimitetit në aspektin subjekti të palës pasive, Certifikata e pronësisë me nr. të lëndës 3285/22, e dt. 17.08.2022, e lëshuar për ngastrat 01884-0, 01903-0 si dhe 01929-0, ku nga e njëjta certifikatë gjykata vërtetoi faktin se e ndjera S. G, evidentohet si poseduese individuale me 1/1 në këto parcela.

Gjykata, pas shqyrtimit të marrëveshjes së palëve për zgjedhje të ndërmjetësuar konstatoi se kjo marrëveshje i plotëson kriteret e parapara me Ligjin nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, pasi që e njëjta është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në këtë kontest dhe është në përputhje me dispozitat ligjore. Sipas nenit 15 të njëjtit ligj *“Nëse lënda është referuar nga gjykata, marrëveshja e arritur me shkrim i dërgohet gjykatës, e cila pas aprovimit, e ka fuqinë e dokumentit përmbarues sipas ligjit përkatës për procedurën përmbarimore”*. Së këndejmi, duke vepruar konform gjykata aprovoi marrëveshjen e arritur ndërmjet palëve. Si e tillë kjo marrëveshje do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:187793, 04.06.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankese e veçantë sipas nenit 207.2 të ndërlidhur me nenin 181.2 të LPK-së, ku ky aktvendim mund të bëhet i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm që nga lëshimit i të njëjtit sipas nenit 15.1 të Ligjit Për Ndërmjetësim.